

Akt themelimi
i shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
“VG-DM 2022 ENERGY POWER” sh.p.k

Sot me date 03/06/2022 ne mbeshtetje te ligjit per shoqerite tregtare,9901,date 14.04.2008, dhe ligjit te Qendres Kombetare te Regjistrimit 9723, date 03.05.2008, themeluesit,

1- Denis Mekolli i datelindjes 18/07/1986, me nr personal I60718075H lindur Pogradec dhe banues Lagjia nr 4 Rruga Demokracia Pallati Minieres nr 6 Pogradec, madhor per vepruar kanë vendosur themelimin e shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “VG-DM 2022 ENERGY POWER” sh.p.k me qender ne Bashkia Pogradec Fshati Somotinë, Njesia Administrative Proptisht banese private, zona kadastrale nr 3485, numer pasurie 9/6.

Neni 1

Te krijome nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar e emertuar “VG-DM 2022 ENERGY POWER” sh.p.k

NENI 2

Kjo shoqeri do te jete e formes se Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar dhe si Person Juridik, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi, aktiviteti i saj rregullohet sipas statutit dhe akt themelimit te shoqerise, si dy akte baze te kesaj shoqerie.

NENI 3

Qendra e kesaj Shoqerie eshte do te jete ne Bashkia Pogradec Fshati Somotinë, Njesia Administrative Proptisht banese private, zona kadastrale nr 3485, numer pasurie 9/6.

NENI 4

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe me vendim te Asamblese se Ortakeve sipas rasteve te parashikuara ne statutin e kesaj shoqerie(shperberja dhe likujdimi).

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise “VG-DM 2022 ENERGY POWER” sh.p.k do te perbehet nga kontributi ne para i oratekve themelues te kesaj shoqerie ne vlere 1.000.000 (njemilion) leke.

Ortaket themelues te shoqerise zoterojne kuotat si me poshte

1. Denis Mekolli 100 % vleres se kapitalit themeltar te Shoqerise te barabarte me 1 pjese me vlere prej 1.000.000 leke.

NENI 6

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar do te shenohet kapitali i derdhur nga ortaket e shoqerise. Rritja dhe zvogelimi i kapitalit fillestar te shoqerise percaktohet sipas rregullave te percaktuara ne statutin e shoqerise me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 7

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane teresisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga Ortaket e Shoqerise.



NENI 8

Objekti i aktivitetit ekonomik do te jete:

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike fotovoltaike dhe gjithë llojeve te tjera te prodhimit te energjise dhe veprave ndihmese ne gjithë territorin e Shqiperise. Prodhim Energjie Fotovoltaike, Hidrike, Solare, etj. Shit-Blerje Energjie Fotovoltaike, Solare, Hidrike, etj. Import Eksport te te gjitha llojeve te materialeve dhe transport. Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha lejeve dhe licencave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise.

Konceptim dhe menaxhim të aktiviteve të kultivimit të kulturave bujqësore dhe blegtorale, e të tjera. Organizim të trajnimeve dhe programeve edukuese në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, si dhe hartim projektsh dhe dokumentacionesh per thithje fondesh dhe aplikime te ndryshme.

NENI 9

Organet drejtuese te shoqerise “VG-DM 2022 ENERGY POWER” sh.p.k jane:

1. Asambleja e Ortakeve
2. Administratori I shoqerise

Modalitet dhe procedura e emerimit, shkarkimit, kohezgjatja e mandatit dhe kompetencat e administratorit caktohen ne statutin e shoqerise. Administratore i shoqerise eshte znj Marsilda Mekolli e datelindjes 01/09/1990 me afat 2 vjeçar.

Neni 10

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane te percaktuar dhe inicialet e emertimit te saj. Fillimin e aktivitetit te saj tregtar kjo shoqeri e lidh me regjistrimin prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe me marrjen e Nipt-it perkates.

NENI 11

Dizpozita me te hollësishme jane parashikuar ne Statutin e kesaj shoqerise, i cili shpreh vullnetin e lire te themeluesve

SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR **“VG-DM 2022 ENERGY POWER” sh.p.k** **ORTAKU THEMELUES**

Denis Mekolli

